

Informacione për prindër rreth shkollës fillore në Reykjavík

Detyrimi shkollor

Të gjithë fëmijët detyrohen të shkojnë në shkollë posa ata arrijnë moshën 6-vjeqare, arsimi i detyruar zgjat 10 vjet, pas të cilit nxënësit mund të aplikojnë në shkollat e mesme dhe më pas në universitete. Pothuajse të gjithë fëmijët në Reykjavík kanë qenë 3-4 vjet në kopshtin e fëmijëve [leikskóla](#) para se të fillojnë shkollën fillore.

Orari shkollor

Viti shkollor fillon rreth 20 gushtit dhe përfundon në fillim të qershorit, gjithsej 180 ditë mësimdhënie . Çdo pranverë shkollat japin kalendarin shkollor ku mund të shihet planifikimi i vitit shkollor.

Shkollat nuk fillojnë të gjitha në të njëjtën kohë në mëngjes, por në përgjithësi fillojnë prej orës 8-9. Mësimi zakonisht përfundon në ora 14-16.

Nxënësit nga klasa e 1 - 4 kanë mesatarisht 20 orë mësimi në javë në shkollë, nga klasa e 5 - 7 rreth 23 orë, ndërsa nga klasa 8- 10 rreth 25 orë. Shuma e mësimdhënies merr parasysh programin standard- kurrikula për shkolla fillore të miratuar në vitin 2008. ([aðalnámskrá grunnskóla, 2008](#)).

Lëndet Mësimore	Klasa e 1.-4.	Klasa e 5.-7.	Klasa e 8-10	Mësimi javor	Mësimi javor
Fusha e studimit	Koha gjithsej minuta në javë klasa 1.-4.	Koha gjithsej minuta në javë klasa 5.-7.	Koha gjithsej minuta në javë klasa 8.-10.	Koha gjithsej minuta në javë klasa 1.-10.	Përqindja
Islandisht, Islandishtja si gjuhë e dytë, Islandishtja e shurdhmemecëve	1.120	680	630	2.430	18,08 %
Gjuhë e huaj: Anglisht, Danisht ose ndonjë gjuhë tjetër Skandinave	80	460	840	1.380	10,27 %
Art- lëndë artizanale	900	840	340	2.080	15,48 %
Shkenca Natyrore	420	340	360	1.120	8,33 %
Sport shkollor	480	360	360	1.200	8,93 %

Shkenca shoqërore Njohuri fetare Aftësi jetësore Barazi njerëzore Etikë	580	600	360	1.540	11,46 %
Matematikë	800	600	600	2.000	14,88 %
Informatikë dhe Teknologji	120	160	80	360	2,68 %
Lëndë zgjedhore	300	160	870	1.330	9,90 %
Totali	4.800	4.200	4.400	13.400	100 %

Ushqimi / parashujta

Prindërit mund të blejnë ushqim të nxehtë për drekë me çmim të volitshëm për fëmijët e tyre. Më hollësisht këtu: [Sjá nánar hér](#). Përveq kësaj shkollat shpesh rekomandojnë që fëmijët të vijnë me parashujtë- ushqime të shëndetshme të tilla si p.sh. fruta për të ngrënë në mes racioneve.

Në cilën shkollë duhet të shkoj fëmija?

Të gjithë fëmijët kanë përparësi në shkollën e lagjes ku banojnë dhe duhet të marrin mësimin përkatës. Prindërit gjithashtu mund të aplikojnë për të marrë pjesë në shkolla të lagjeve tjera ose në ndonjë shkollë të pavarur për fëmijën. Shiko informacionet në: [skólahverfi](#)

Aktivitetet e lira pas-shkollore

Pas përfundimit të mëimit për fëmijët 6-9 vjet ofrohet pjesëmarrja në aktivitete të lira në [frístundaheimilum](#). Qendrat e aktiviteteve pas-shkollore janë të vendosura në lokalet e shkollave ose në afërsi të tyre dhe janë të hapura gjatë ditëve të punës deri në ora 17:15. Roli i aktiviteteve pas-shkollore është që të sigurojë një kohë të lirë kuptimplote ku fëmijët kanë mundësinë për t'u marrë me sfida të ndryshme. Qëndrimi në aktivitetet pas-shkollore është me pagesë. Fëmijët dhe adoleshentët e moshës 10-16 vjet mund të marrin pjesë në Qendrën Rinore [félagsmiðstöðva](#). Aty fëmijëve u ofrohet lëvizje dhe shoqëri, me bashkëmohatarët e tyre në një mjedis të sigurt. Fokusi i Qendrave Rinore dhe aktiviteteve pas-shkollore është i përqendruar për të ju mundësuar fëmijëve dhe të rinjve të marrin pjesë aktivisht në punë dhe projekte, duke promovuar aftësitë sociale dhe për të forcuar identitetin e tyre. Qendrat Rinore dhe aktivitetet pas-shkollore kërkojnë bashkëpunim edhe me shoqëri të tjera të pavarura që merren me aktivitete të lira, në qytet. Në web-faqen, www.fristund.is, gjenden informacione të hollësishme për aktivitetet në dispozicion për kohën e lirë në Reykjavík.

Regjistrimi në shkollat fillore në Reykjavík

Qyteti i Reykjavík-ut ka 39 shkolla fillore, [39 grunnskóla](#) por ka edhe 7 shkolla të tjera [Z sjálfstætt reknir](#) që operojnë në mënyrë të pavarur.

Regjistrimi në shkolla fillore dhe në aktivitete pas-shkollore, kryhet nëpërmjet faqës elektronike të Reykjavík-ut, [Rafræna Reykjavík](#). Nëse fëmijët nuk kanë adresë banimi në Reykjavík ose nuk kanë numër personal, regjistrimi bëhet drejtpërdrejt në shkolla fillore. Më shumë informacione merrën në sfs@reykjavik.is dhe numër telefoni: 411 11 11.

Nëse fëmijët regjistrohen në shkollë të pavarur, shkolla të veqanta ose shkojnë jashtë vendit kërkohen informacione për këtë dhe dërgohen në adresen: sfs@reykjavik.is.

Kur fëmijët, që jetojnë në Reykjavík shkojnë në shkolla publike jashtë Reykjavík-ut duhet të plotësohet një kërkesë e veçantë për mësim jashtë vendbanimit primar që mund të gjindet në web-faqen e aktiviteteve pas-shkollore dhe komunës së Reykjavík-ut: [beiðni um námsvist í grunnskóla utan lögheimilis sveitarfélaga](#).

Pranimi i fëmijëve të të huajve të cilët janë shpërngulur së fundmi në kryeqytet mbështetet në planin e pranimit të fëmijëve me një gjuhë amtare tjetër ndaj asaj islandeze. [Móttökuáætlun barna með annað móðurmál en íslensku](#).

Shkolla luan një funksion shumë të rëndësishëm shoqëror për të gjithë fëmijët. Pjesa më e madhe e prindërve zgjedhin shkollën e lagjes, kështu gjasat rriten që fëmija të ketë shokët dhe të njohurit në komunitetin lokal, si dhe të jetë sa më afër për fëmijën për të ndjekur shkollën.

Nxënësit e shkollave fillore janë grup i ndryshëm dhe nevojat e tyre janë të ndryshme

Shkollat fillore në Reykjavík punojnë sipas filozofisë gjithëpërfshirëse, pa dallim. Arsimi gjithëpërfshirës është proces i vazhdueshëm i cili ka për qëllim të sigurojë një arsim cilësor për të gjithë. Respektohet shumëllojshmëria dhe nevojat e ndryshme, aftësitë dhe karakteristikat e nxënësve me theks të veçant eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në shkolla (Kurrikula për shkolla fillore 2011).

Bashkëpunimi mes shkollave dhe prindërve në edukimin dhe mirëqenien e fëmijës

Shkolla fillore i jep theks të veçant bashkëpunimit të mirë me të gjithë prindërit si pikësypnim mirëqenien e fëmijës. Hulumtimet tregojnë se asnjë faktor i vetëm nuk ka aq shumë ndikim në arritjen dhe mirëqenien e nxënësve në shkollë, se sa interesimi dhe mbështetja e prindërve në arritshmëritë e fëmijëve të tyre. Shkolla kërkon me të gjitha mjetet të ju jep mundësi prindërve në edukimin e fëmijëve në kriteret e secilit . Mirëqenia e fëmijës është e siguruar mirë me bashkëpunim midis prindërve dhe shkollave bazuar në besimin dhe respektin e ndërsjellë. Stafii shkollor merr për zemër mirëqenien e nxënësve dhe përpiqen për të garantuar sigurinë e nxënësve, mirëqenien dhe paqen në punë, që ata të mund të shijojnë

vitet e tyre shkollore. Stafi duhet të promovojnë atmosferë pozitive në shkollë, punë dhe marrëdhënie të mira në të gjitha aktivitetet shkollore.

Këtu janë disa këshilla se si prindërit duhet të marrin pjesë në arsimimin dhe mirëqenjen e fëmijëve të tyre në shkollë.

[Hér eru nokkur ráð til foreldra um hvernig þeir geta stutt við nám og líðan barna sinna í skólanum.](#)

Faqja e prindërve [Foreldrarvefurinn](#)- përmban më shumë informacione dhe këshilla praktike për prindërit.

Përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e prindërve.

Prindërit e një fëmije të shkollës fillore janë përgjegjës për regjistrim, kur ai arrinë moshën që të shkoj në shkollë.

Prindërit mbajnë përgjegjësi për rritjen e fëmijëve të tyre. Prindërit gjithashtu mbajnë përgjegjësi bashkë me fëmijët e tyre, për sjelljen dhe qëndrimin e tyre ndaj nxënësve të tjerë dhe stafit shkollor dhe duhet të reagojnë për pasojat e mundshme të sjelljes së fëmijëve të tyre në shkollë.

Prindërit ruajnë interesat e fëmijëve të tyre dhe duhet të kontribuojnë për pjesëmarrjen në mësim. Ata duhet të përcjellin progresin në bashkëpunim me ta dhe mësuesit. Prindërit duhet të kenë shancë për tu përfshirë në arsimin e fëmijëve të tyre dhe në përgjithësi me punën në shkollë, në konsultim me mësuesin kujdestar dhe mbikëqyrësit e shkollës.

Prindërit duhet të raportojnë në shkollë faktorët që mund të ndikojnë në arritjet shkollore, pjesëmarrje dhe sjellje, të tilla si shqetësimet e fëmijëve dhe pengesat e tyre që mund të ndikojnë në shkollim, si dhe ndryshimet dhe rrethanat të jenë në interes të tyre.

Prindërit detyrohen të punojnë për zgjidhjen e qështjeve në bashkëpunim me shkollat, shërbimet profesionale dhe autoritetet arsimore lokale, kur dështon mirësjellja dhe paraqitja e fëmijëve të tyre.

Prindërit, së bashku me fëmijën duhet të marrin pjesë në procedimin e qështjes, por nëse prindërit ose administratorët e shkollës numërojnë se mungon besimi në zgjidhjen e kontekstit të qështjes së fëmijës, preferohet të kërkohet ndihmë nga palët e pavarura.

(Paragrafi 5. Rregullorja për përgjegjësitë dhe detyrimet e komunitetit të shkollës fillore).

Shih edhe përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e nxënësve dhe stafit shkollor

[ábyrgð, réttindi og skyldur nemenda og starfsfólks skólans](#)

Informacione

Zakonisht informacionet për fëmijën dhe punën në shkollë shpërndahen te prindërit nëpërmjet komunikimit elektronik, e-mail, telefonata apo takime, të cilat mbahen të paktën dy herë në vit. Këtu ka këshilla të dobishme për prindërit për takime të tilla . [Hér eru gagnleg ráð til foreldrar fyrir slíka fundi](#). Prindërit inkurajohen të japin informacione të nevojshme në shkollë në lidhje me fëmijën dhe sjelljet e tij. Zakonisht, prindërit janë të ftuar për prezantime apo takime në shkollë shpesh në bashkëpunim me shoqatën e prindërve. Ata gjithashtu janë të inkurajuar të njoftohen për programin arsimor të fëmijës së tyre në mënyrën më të mirë dhe punën në shkollë, duke vizituar shkollën në konsultim me mësuesit. Kur prindërit kërkojnë këtë, ofrohet shërbimi i përkthyesëve. Më së miri është kur prindërit dhe shkolla bien dakord për mënyrën më të mirë të komunikimit.

Stafi shkollor duhet të ruajë fshehtësinë e plotë në të mirë të fëmijëve dhe prindërve të tyre, ata janë të vetëdijshëm se duhet të punohet konfidencialisht sipas ligjit, udhëzimeve të udhëheqësve dhe natyra e qështjes. Gjithashtu, rekomandohet që prindërit të respektojnë rregullat e konfidencialitetit në shkollë që të mos diskutojnë jashtë, atë që ata e dijnë për çështjet dhe rrethanat e fëmijëve të tjerë.

Shoqata e prindërve dhe këshilli shkollor

Në të gjitha shkollat veprojnë shoqata e prindërve dhe këshilli shkollor [foreldrafélög og skólaráð](#). Të gjithë prindërit janë anëtarë të shoqates së prindërve e cila zgjedh udhëheqjen. Në broshurën [Stoðir í skólastarfi](#), ka informacione në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e shoqatave të prindërve dhe këshillave të shkollave. Prindërit në çdo klasë ose grup nxënësish zgjedhin një përfaqësues të klasës [bekkjafulltrúa](#) . Puna e tyre konsiston në radhë të parë të jenë udhëheqës i grupit të prindërve në klasë, të parët mes të barabartëve.

Vëzhguesi nga organizata e shoqates së prindërve [SAMFOK s](#) përgatitë takime e mbledhje të Këshillit të aktiviteteve pas-shkollore të qytetit të Reykjavík-ut.

Këshilli i shkollave dhe aktiviteteve pas-shkollore në Reykjavík

Këshilli i shkollave dhe aktiviteteve pas-shkollore harton politika në çështjet e arsimit dhe kohës së lirë përmes qytetit të Reykjavík-ut, merr vendime dhe bën rekomandime për këshillin e qytetit se çka përfshinë zona e punës së tyre. Për më tepër, këshilli kontrollon strategjitë qytetare për çështjet arsimore dhe rekreative dhe monitoron cilësinë e aktiviteteve pas-shkollore. Këshilli do të kryejë edhe detyra të tjera që përcaktohen nga Këshilli i Qytetit. Këshilli shkollor dhe pas-shkollor merret me detyra të drejtorisë arsimore sipas ligjeve të shkollave fillore 66/1995.

Gjuha amëtare dhe Islandishtja

Njohja e mirë e gjuhës amëtare dhe asaj islandeze është pasuri si për individin ashtu edhe për shoqërinë, pasuri të cilën duhet kultivuar dhe ruajtur. Studiuesit theksojnë se njohja e gjuhës amëtare te fëmijët ndikon shumë në mësimin dhe zhvillimin e tyre, një bazë e mirë në gjuhë

amtare mund të ketë një ndikim të thellë në të mësuarit e një gjuhe tjetër, kur bëhet siç duhet. Nga kjo studiuësit kanë treguar se respektimi i gjuhës amtare, mund të ketë një ndikim të madh në zhvillimin e identitetit dhe vetëbesimit të fëmijëve në aftësitë e tyre. Studimet kanë treguar se dygjuhësia aktive është më e suksesshme për edukimin dhe jetën e fëmijëve. Kjo nënkupton kur një gjuhë e re i shtohet gjuhës amtare, por nuk mund ta zëvendësojë atë. Një dygjuhësh aktiv përparon dhe ka ndikim pozitiv në arritje-mësim, derisa ndërrimi i gjuhëve ka ndikim negativ. Aftësia në gjuhë amtare është çelësi për të mësuar një gjuhë të dytë, si dhe ka të ngjarë të mbështesë zhvillimin e njohurive në fusha të tjera. Hollësisht shiko këtu: [Heimurinn er hér](#).

Material bashkangjites

- Ligjet për shkolla fillore: <http://www.althingi.is/lagas/140a/2008091.html>
- Kurrikula e shkollave fillore në Islandisht dhe Anglisht: <http://www.menntamalaraduneyti.is/utgefid-efni/namskrar/adalnamskra-grunnskola/>
- Sistemi shkollor islandez. Ministria e arsimit dhe kultures: <file:///C:/Users/nannakc2099/Downloads/islenskaskolakerfid.pdf>
- Avokat- autorizuesi për fëmijë: <https://www.barn.is/>
- Ligjet e ndaluara: <http://www.althingi.is/lagas/140a/2003076.html>
- Ligjet për mbrojtjen e fëmijëve: <http://www.althingi.is/lagas/nuna/2002080.html>
- Rregullorja e këshillit shkollor për shkolla fillore: <http://www.reglugerd.is/reglugerdir/allar/nr/1157-2008>
- Faqja e prindërve: <http://eldri.reykjavik.is/desktopdefault.aspx/tabid-4576>
- Bota është këtu: http://reykjavik.is/sites/default/files/fjolmenningarstefna_oppsett.pdf
- Plani i pranimit të fëmijëve me Islandishte si gjuhë të dytë: <http://reykjavik.is/mottokuaaetlun-vegna-barna-med-islensku-sem-annad-tungumal>
- Útdráttur úr fjölmennningarstefnu SFS : http://information.leikskolar.is/docs/heimurinn_er_her_isl_baeklingur.pdf
- Þjónusta við innflytjendur í Reykjavík: http://reykjavik.is/sites/default/files/ymis_skjol/skjol_utgefid_efni/thjonusta_vid_innflytjendur.pdf
- Byfeja në shkolla fillore: <http://reykjavik.is/thjonusta/motuneyti-i-grunnskolum>
- Reykjavíku elektronik: <https://rafraen.reykjavik.is/pages/#logged-out>
- Rregullat e qëndrimit jashtë shtëpisë: <http://www.skagastrond.is/utivistareglur.pdf>
- Nxënësit me Islandishte si gjuhë të dytë: <http://akmennt.is/erlendir/>
- Organizata e gjuhës amtare për dygjuhëshat: <http://www.modurmal.com/modurmal.pdf>
- Shtyllat e punës në shkolla http://reykjavik.is/sites/default/files/skjol_thjonustulysingar/Stodir_2011.pdf

- Qendra shumækulturore <http://www.mcc.is/fjolmenningarsetur/faldar-greinar/nr/782>
- Við og börnin okkar: http://eldri.reykjavik.is/portaldata/1/Resources/mannr_ttindaskrifstofa/skjol/Vi_og_bo_rnin_okkar_I_sl_En.pdf
- Málskilningur – Sameiginleg ábyrgð: http://eldri.reykjavik.is/Portaldata/1/Resources/skola_og_fristundasvid/skjol/M_Iskilningur-fyrsta_skolastig.pdf
- Skilaboð frá skólanum á ýmsum tungumálum: <http://reykjavik.is/skilabod-fra-skola-0>
- Orðalistar, eyðublöð og fleira hagnýtt: <http://reykjavik.is/ordalistar-eydublod-og-fleira-hagnytt>